



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

Nr 2542 Prot

Tiranë, më 24.09.2018

**THIRRJA PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR
KANDIDATË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË**

Drejtuar : PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË APELEVE

Në mbështetje të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë do të jenë 6 anëtarë prokurorë, nga të cilët; 1 anëtar nga Prokuroria e Përgjithshme, 2 anëtarë nga Prokuroritë e Apelit; dhe 3 anëtarë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

Pas informacionit të ardhur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimi, me nr. Prot. 6250, datë 20.09.2018, mbi ecurinë e procesit të rivlerësimit për prokurorët e listës prioritare, kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se nga kandidaturat e Prokurorive të Apeleve vetem 1 (një) prokuror është konfirmuar në detyrë.

Përsa më sipër ftojmë prokurorët e interesuar që plotësojnë kriteret sipas ligjit 115/2015 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të sjellin dokumentet pranë Prokurorisë së Përgjithshme .

Të interesuarit krahas kërkesës me shkrim, të bashkangjisin dhe dokumentet e mëposhtme:

- a) jetëshkrimin e përditësuar;
- b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkuara rregullisht;
- c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;

dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

e) informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor.

ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

g) Formularin e Autoritetit për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Të interesuarit kanë **15 ditë** kohë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

